

FOL

TETOR
2017

MONITORIMI I PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVE: NGRITJA E LLOGARIDHËNIES SË INSTITUCIONEVE PËR MËNYRAT E SHPENZIMIT TË PARASË PUBLIKE

LËVIZJA FOL



Ky projekt u financua nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinionet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

Përmbajtja

Përmbledhje.....	3
Hyrje.....	5
Metodologjia.....	6
Të gjeturat.....	9
Ministria e Shëndetësisë.....	10
Raporti i vlerësimit të tenderëve	12
Loti 1.....	12
Loti 4.....	12
Loti 5.....	12
Loti 6.....	13
Loti 7.....	14
Kontratat publike	14
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	15
Raporti i vlerësimit të tenderit.....	17
Operatorët ekonomikë	17
Kontratat publike kornizë	18
Konkluzione dhe rekomandime	19

“Lidhja mes korrupsionit dhe transparencës është bërë kaq aksiomatike gjatë viteve sa që të dy termet janë bërë të pandashëm nga njëri-tjetri”

Përmbledhje

Ky raport paraqet të gjeturat nga monitorimi 3-mujor i kontratave me vlerë të mëdha nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Përgjatë kësaj periudhe, Lëvizja FOL ka marrë përgjigje nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe nga Ministria e Shëndetësisë. Procesi i monitorimit të këtyre tri ministrive vazhdon ende, për shkak të disa të gjeturave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe kontaktit që kemi arritur të kemi me Ministrinë e Infrastrukturës.

Nga monitorimi i tërësishëm i procesit të prokurimit rezultojnë këto të gjetura:

1. Prokurimi publik mbetet një sektor jotransparent ndaj publikut pasi që qasja në dokumentacionin e kontratave mbetet e kufizuar. Në shumë raste, institucionet hezitojnë të hapin këto dokumente siq është rasti i Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk na ka dhënë qasje në planin e menaxhimit të kontratës së monitoruar. Ndërkaq, Ministria e Infrastrukturës, në anën tjetër nuk ka ofruar qasje në asnjërën prej kontratave të kërkuara nga Lëvizja FOL, duke injorur kështu kërkesën për qasje në dokumente publike;
2. Ligji për Prokurimin Publik mbetet i parespektuar nga institucionet dhe zyrtarët përkatës. Dy kontrata të monitoruara nga FOL në Ministrinë e Shëndetësisë janë nënshkruar nga ushtruesi i detyrës si udhëheqës i departamentit të prokurimit, ndonëse dyshohet se nuk posedon certifikatë të prokurimit të lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik;
3. Mungesa e dokumenteve standarde, bën që vlerësimi dhe krahasimi i dokumenteve të jetë më i vështirë dhe rezultatet të jenë më të zbehta. Në të dy ministrinë që kemi monitoruar, procesverbalet e hapjes së tenderëve nuk përmbajnë informacione më të detajizuara rreth vlerësimit të ofertave dhe operatorëve ekonomikë;
4. Ndonëse në të dy kontratat e monitoruara, kriter kryesor për dhënien e kontratës mbetet çmimi më i ulët, shumë operatorë ekonomikë diskualifikohen nga gara për aktivitetin e prokurimit, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve administrative, ku hyjnë dokumentet bazike si kopjet e formularëve të tenderit e dokumentet e regjistrimit të biznesit;
5. Autoritetet Kontraktuese në shumë raste ballafaqohen me keqplanifikim të aktivitetit të prokurimit, pasi që ofertat e operatorëve ekonomikë tejkalojnë në mënyrë drastike limitet e parashikuara buxhetore të autoriteteve kontraktuese. Për pasojë, kjo shpesh çon në anulimin e loteve, siç është rasti në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ku për arsye të tillë anulohen dy lote të parashikuara në kontratë. Të njejtën e kemi hasur edhe në Ministrinë e Shëndetësisë ku loti është anuluar pas nënshkrimit të kontratës me pretendimin e Autoritetit Kontraktues së çmimi i ofruar ka qenë shumë më i lartë së çmimi i tregut.
6. Konkurrenca e vogël mes operatorëve ekonomikë mbetet mjaft problematike për prokurimin publik. Shumë operatorë ekonomikë janë mësuar të jenë të vetmit në garë

për një produkt/punë të caktuar duke bërë që në ofertat e kohë pas kohshme të mos i ndyshojnë vlerat e produkteve.

Hyrje

Prokurimi publik paraqet një proces të komplikuar përmes të cilit shpenzohet pjesa më e madhe e parasë publike. Si i tillë, konsiderohet ndër proceset më të ndjeshme ndaj korrupsionit, peshën dhe pasojat e të cilës i ndjejnë direkt taksapaguesit (TI, 2004).

Duke u përceptuar si problemi i dytë më i madh nga qytetarët në Kosovë (FOL, 2017), korrupsioni ka zënë fill edhe në prokurim publik, i ndihmuar nga mosrespektimi i duhur i Ligjit për Prokurim Publik por edhe nga integriteti dhe përgjegjshmëria e ulët e zyrtarëve të prokurimit në autoritetet kontraktuese.

Raporti i Progresit për vitin 2016 thekson se ndonëse janë bërë përpjekje duke i'u afruar kriterëve të Bashkimit Europian, Kosova ende duhet të punojë në përmirësimin e transparencës në tërë procesin e implementimit të aktivitetit të prokurimit publik, sidomos në fazën e zbatimit të tenderëve të prokurimit publik si dhe në forcimin e sistemit të kompensimit dhe funksionimin e duhur të prokurimit online.

Për më tepër, është shqetësues edhe fakti se prezenca e korrupsionit dhe keqpërdorimeve në prokurim publik, ndikon edhe në uljen e konkurrencës për punë dhe shërbime të caktuara, duke ndihmuar në krijimin e monopoleve nga kompani të caktuara dhe diskriminimin e kompanive dhe bizneseve tjera. Në vitin 2015, numri mesatar i ofertave për tenderim ra në 5,8 në krahasim me vitin 2014, ku numri mesatar i ofertave ishte 6,1¹.

Një element tjetër që ndikon në shfaqjen e keqpërdorimeve është edhe kapaciteti i autoriteteve për të menaxhuar aktivitetet e prokurimit publik. Ndonëse me Ligjin për Prokurimin Publik është i detyrueshëm certifikimi i zyrtarëve të prokurimit për të pasur autoritetin e nënshkrimit të kontratës, në disa raste, siq është edhe ai i kontratës së monitoruar në Ministrinë e Shëndetësisë, zyrtari përgjegjes i prokurimit nënshkruan kontratën edhe pse nuk është i certifikuar nga KRPP-ja.

Është fakt se tranparenca nuk është lehtë të arrihet, kurse ngurrimi që vjen nga institucionet për hapje të dokumenteve, është ndër sfidat e para me të cilat ballafqohemi në procesin e ngritjes së llogaridhënies dhe kërkesës për transparencë. Me të njejtin ngurrim jemi përballur edhe në kërkesat për qasje në kontrata që i'u kemi drejtuar ministrive. Vetëm përmes presionit që kemi bërë për të respektuar afatet ligjore për përgjigje në kërkesat për qasje kemi arritur të mbajmë takime me zyrtarët e prokurimit në këto ministri, e më pastaj të marrim edhe dokumentet e kërkuara.

Të gjithë këto elemente bëjnë që edhe institucionet por edhe shoqëria civile të angazhohen më shumë për gjetjen e mënyrave më adekuate për të rritur transparencën në këtë fushë. Ndryshimet në Ligjin për Prokurimin Publik janë ende të nevojshme sidomos tek parimet e transparencës, kurse rritja e integritetit të zyrtarëve publikë është esenciale për mbarëvajtjen e procesit të prokurimit publik. Ngritja e llogaridhënies në këtë sektor është e mundur vetëm atëherë kur ana ligjore përputhet me përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe publiku gëzon qasjen që i garantohet me ligj.

¹ Raporti i Progresit për Kosovën 2016

Lëvizja FOL vazhdon angazhimin për të ndikuar në përmirësimin e gjendjes së prokurimit publik përmes projektit që ka për qëllim të analizojë mënyrat e shpenzimit të parasë publike, më specifiku duke monitoruar kontratat që kanë lidhur ministrinë e Kosovës me operatorë ekonomikë.

FOL ka monitoruar kontratat me vlerë të madhe që janë kontraktuar nga ministrinë përgjatë vitit 2017, në këtë mënyrë duke u munduar të plasoj tek publiku procedurat e dhënies së kontratave dhe të ndikoj që procesi i prokurimit publik të jetë më i hapur.

Target i këtij projekti kanë qenë tri ministri: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Infrastrukturës. Ligji për Qasje në Dokumente Publike, bën që tërë dosja e një kontrate të jetë e qasshme për publikun, duke na dhënë mundësi që të analizojmë secilën fazë të aktivitetit të prokurimit për të parë respektimin e procedurave si nga ana e operatorëve ekonomikë por gjithashtu edhe nga autoritetet kontraktuese.

Platforma online e prokurimit publik që menaxhohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, ka për qëllim të publikoj në mënyrë elektronike të gjitha kontratat dhe dosjet që kontraktohen nga institucionet e përfshira në aktivitete të prokurimit. Sipas autoriteteve kontraktuese të monitoruara, të gjitha dokumentet e dosjes së kontratave janë të publikuara në platformën online të prokurimit. Megjithatë, aktualisht kjo platformë ofron qasje në këto dokumente vetëm për përdoruesit që regjistrohen si operatorë ekonomikë, duke e bërë kështu të pamundur që qytetarët të kenë qasje në këto dokumente.

Lëvizja FOL, duke u thirrur në dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike si dhe në Ligjin për Prokurimin Publik, përkatësisht në promovimin e transparencës, ka arritur të marrë kopjet fizike të dosjeve të kontratave të përzgjedhura. Gjatë mbledhjes së të dhënave, u është kushtuar rëndësi dokumenteve të cilësuar si sekrete afariste dhe çdo dokumenti tjetër që në një mënyrë a tjetër do të ndikonte në dëmtimin e operatorëve ekonomikë. Zyrtarët nga departamentet e prokurimit, kanë filtruar këto të dhëna duke na dhënë qasje vetëm në dokumentet që konsiderohet publike me ligj.

Të gjeturat e FOL-it vënë edhe njëherë në pah domosdoshmërinë për monitorimin e vazhdueshëm të prokurimit publik, për t'i lënë rrugë jo vetëm respektimit të ligjit për prokurimin publik por edhe përgjegjshmërisë së zyrtarëve dhe punonjësve të prokurimit për t'a kryer detyrën me integritet dhe duke zbatuar ligjin.

Metodologjia

Monitorimi i kontratave të prokurimit publik është realizuar përmes një metodologjie që kombinon metodën deskriptive dhe atë të vëzhgimit. Duke qenë se dosja e një kontrate përmban një sërë dokumentesh që përfshijnë faza të ndryshme të zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, kjo na ka lejuar të kontrollojmë të dhënat bazuar edhe në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për të vazhduar me analizën krahasuese në fazën e dhënies së kontratës.

Kontratat e monitoruara janë përzgjedhur në bazë të vlerës së tyre dhe llojit të punës për të cilën janë kontraktuar. Target i monitorimit tonë kanë qenë kontratat me vlerë të madhe, e që sipas Ligjit për Prokurimin Publik, konsiderohen kontratat:

“(...)1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro; ose

1.2. kontrata për punë, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se pesëqind mijë (500.000) Euro (...)”².

Duke qenë se numri i kontratave me vlerë të madhe të kontraktuara nga ministritë e targetuara është shumë i madh, janë monitoruar vetëm kontratat e mëdha të cilat janë kontraktuar nga Janari i vitit 2017 e tutje. Megjithatë, siq edhe u cek mësipër, FOL ka marrë dokumentet e kontratave në kopje fizike dhe kjo e ka bërë të pamundur që përgjatë periudhës tre-mujore të implementimit të projektit, të monitorohet një numër i madh i kontratave, prandaj FOL ka zgjedhur nga një kontratë prej secilës ministri dhe ka vazhduar me analizimin e implementimit të tyre.

Kërkesat për qasje në dosjet e kontratave të përzgjedhura janë dërguar tek ministritë me email. Meqenëse platforma online e prokurimit publik e-procurement, nuk ofron qasje për çdo shfrytëzues por vetëm për përdoruesit e regjistruar si operatorë ekonomikë, neve na është dashur që të marrim kopjet fizike të të gjitha dokumenteve të kërkuara.

Mes tjerash, FOL ka mbajtur takime me zyrtarët e prokurimit të ministrive përkatëse për të marrë dokumentacionin e kërkuar. Përkundër ngurrimit për të dhënë dosjet e këtyre kontratave nga ana e zyrtarëve të prokurimit, FOL ka arritur të ketë qasje në kopjet fizike të dosjeve të kontratave të kërkuara.

Duke qenë dokument publik, dosja e një kontrata së bashku me çdo dokument që përmban paraqiten të qasshme për publikun në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Dosja e një kontrate zakonisht përmban këto dokumente:

- *Kontrata e lidhur me fituesin, duke përfshirë të gjitha anekset dhe adendumet e saj*
- *Të gjitha dosjet e tenderit, të dorëzuara në lidhje me prokurimin e caktuar, përkatësisht dosjet e tenderëve të operatorë ekonomikë me të cilët janë lidhur kontratat, si dhe dosjet e tenderëve të të gjithë operatorëve ekonomik*
- *Procesverbali i hapjes së dosjeve*
- *Raporti i vlerësimit të ofertave*
- *Kopjet e ankesave të dorëzuara në lidhje me këto aktivitete të prokurimit*
- *Plani i menaxhimit të kontratave*
- *Aktivitetet e kryera për menaxhimin e këtyre kontratave:*
 - Rishikimet e Kontratës*
 - Të dhënat mbi përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë*
 - Inspektimin e vendit të punimeve dhe materialeve*
- *Pagesat e bëra rreth ekzekutimit të kontratës.*

² Ligji Nr. 04/L-042, Neni 19

Kontratat që janë monitoruar nga FOL janë dhënë në muajt Maj-Qershor 2017, ndërsa implementimi i pjesës më të madhe të kontratave ka qenë i paraparë brenda muajve Gusht-Shtator, duke bërë që të mos kemi në dispozicion të dhëna rreth inspektimit të vendit të ekzekutimit apo në pagesat e bëra për ekzekutimin e kontratës.

Gjatë monitorimit të kontratave, është përdorur faqja e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për të krahasuar datat dhe të dhënat rreth shpalljes së kontratës, dhënies së kontratës dhe njoftimeve tjera, për t'i krahasuar me dokumentet që kemi marrë nga ministritë. Me anë të këtij krahasimi kemi arritur të kuptojmë nëse janë respektur afatet për dhënie të kontratës si dhe kemi marrë informatat e nevojshme në raste kur lote të ndryshme janë dërguar për rivlerësim.

Dokumentet e rasteve të anulimit të kontratës apo pjesët e kontratës të dërguara në rivlerësim janë marrur nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të analizuar shkaqet e anulimit/rivlerësimit, ankesat dhe reagimet e operatorëve ekonomikë si dhe procedimin e këtyre rasteve.

Më tutje përmes procesverbaleve të hapjes së tenderëve kemi arritur të analizojmë procedurën e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë dhe saktësinë e përdorur nga komisionet vlerësuese rreth përpikshmërisë së operatorëve ekonomikë. Nga këto procesverbale kemi kuptuar se sa i kanë respektuar operatorët ekonomikë procedurat administrative por edhe konkurrencën në çmime dhe kriteret e dhënies së kontratave.

Sa i përket përbërjes së komisioneve vlerësuese, përmes monitorimit jemi munduar të vlerësojmë objektivitetin gjatë vlerësimit të ofertave dhe ndonjë relacion të mundshëm mes anëtarëve të komisionit vlerësues me operatorët ekonomikë që do të çonte në diskriminim të operatorëve tjerë. Për më tepër duke bërë ndërlidhjen mes këtyre komisioneve dhe procesverbalit të hapjes së tenderëve janë analizuar arsyetimet që janë dhënë nga komisionet vlerësuese në rastet e dhënies së kontratës por edhe në raste kur lotet janë anuluar apo janë dërguar për rivlerësim.

Operatorët ekonomikë, duke qenë pika kyqe ndaj të cilëve edhe është fokusuar më shumë monitorimi, janë analizuar gjatë të gjitha fazave të kontratës, duke u nisur që nga respektimi i afateve kohore për të dorëzuar ofertën me gjithë dokumentacionin përcjellës e deri tek përcaktimi i çmimit dhe përshtatshmëria për punën e kontraktuar.

Vlerësimi i operatorëve ekonomikë duke qenë procesi kryesor i tërë monitorimin paraqitet me të dhëna grafike për të gjitha lotet e kontratës, në mënyrë që të shihet qartësisht se çfarë ka ndikuar që një operatorë të fitoj tenderin e kontratës së caktuar.

Në kontratat që kemi monitoruar kemi ndeshur me një lot të anuluar, e që është përcjellur me ankesë nga operatori ekonomik për anulimin e dhënies së kontratës. Kjo ankesë drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit është vëzhguar për të parë validitetin e vendimit të komisionit vlerësues dhe shpjegimin e ekspertit të OShP-së kundrejt vendimit për anulimin e lotit të caktuar.

Në kontratat publike të lidhura me operatorët ekonomikë janë analizuar të gjitha dispozitat rreth afateve kohore dhe detyrimeve që ka operatori ekonomik kundrejt autoritetit kontraktues për

aktivitetin e kontraktuar. Në kontratën e monitoruar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kontratat kanë pasur të bashkangjitur edhe planin për menaxhimin e kontratës. Mirëpo duke qenë se ekzekutimi i këtyre kontratave ka qenë ende në fazat e para, ky dokument nuk ka qenë i plotësuar me të dhëna të fundit, por vetëm të dhënat bazike rreth menaxherit të kontratës dhe afateve kohore lidhur me punën e kontraktuar.

Ndërsa në Ministrinë e Shëndetësisë, nuk kemi arritur të marrim planin për menaxhimin e kontratës. Edhe pse FOL ka kontaktuar zyrtarët e departamentit të prokurimit dhe ka insistuar për të pasur qasje në këtë dokument, zyrtarët nuk i janë përgjigjur kërkesës tonë.

Të gjeturat

Nga monitorimi i kontratave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, janë vënë në pah disa parregullësi që kanë përcjellur secilën fazë të aktivitetit të prokurimit në fjalë.

Njoftimet për kontratë në platformën e-prokurimi ngatërrojnë numrat e kontratave, duke vënë njoftimin për të njejtën kontratë diku me numër prokurimi, e në vendet tjera me numër prokurimi të brendshëm. Kjo ka shkaktuar paqartësi edhe tek ne si monitorues, pasi që duke qenë se platforma nuk ofron qasje më të detajizuara, tek njoftimet për prokurim figuronin dy kontrata me numra e të ndryshëm. Këtë problem e kemi hasur tek kontrata e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në takim me zyrtarët e kësaj ministrie, na është sqaruar se KRPP-ja publikon kontratat vetëm me numër prokurimi, kurse kjo ministri edhe me numrin e brendshëm të prokurimit.

Afatet kohore të përcaktuara në LPP për procedurat e prokurimit janë respektuar si nga autoritetet kontraktuese poashtu edhe nga operatorët ekonomikë. Këtë e kemi parë nga njoftimet për kontratë si dhe nga të dhënat në procesverbalet e hapjes së tenderëve. Sa i përket respektimit të afateve kohore për ekzekutimin e kontratës, këtë nuk kemi arritur t'a verifikojmë pasi që kontratat që kemi monitoruar ende nuk i kanë përfunduar aktivitetet e parashikuara.

Nga monitorimi i kontratave kemi vërejtur që një pjesë e madhe e operatorëve ekonomikë janë diskualifikuar nga procesi i tenderimit për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, 3 nga 7 operatorët ekonomikë janë diskualifikuar për shkak të mospërmbushjes së kërkesave administrative dhe formale.

Kërkesa për qasje në dokumente publike, nuk ka marrë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës. FOL ka shtruar ankesë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, me ç'rast ankesa është pranuar dhe janë zhvilluar hetimet e nevojshme me këtë ministri. Pas një periudhe tre-mujore, Lëvizja FOL ka arritur të kontaktojë me departamentin e prokurimit në këtë ministri dhe është në fazën e përzgjedhjes së kontratës për monitorim.

Ministria e Shëndetësisë

Në Ministrinë e Shëndetësisë është analizuar kontrata me numër prokurimi 206-17-452-1-1-1, me titull “Furnizim me barna nga Lista Esenciale”. Duke hyrë në kategorinë e furnizimeve, kjo kontratë ka qenë e ndarë në 9 lote, me vendodhje kryesore të punëve në depot përkatëse të barnave për kujdesin primar dhe sekondar. Më saktësisht, Lotet 1-8 për Departamentin e Farmacisë, kurse Loti 9 për Agjencionin e Financimit të Shëndetësisë. Duke ndjekur procedurë të hapur, për të gjitha pjesët e kontratës, kriteri i dhënies ka qenë çmimi më i ulët. Vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 1,700,000 euro.

Njejtë sikur edhe në faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, njoftimi për dhënien e kontratës është përgatitur me datë 18 Maj 2017, ndërkaq data e njoftimit për dhënie të kontratës ka qenë 22 Maj 2017. Të gjitha kontratat janë nënshkruar me operatorët ekonomikë me datë 29 Maj 2017.

Në përbërjen e komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit “Furnizim me barna nga Lista Esenciale, kanë qenë dy farmacistë dhe zyrtari i prokurimit. Propozimi për përbërjen e komisionit për vlerësim është bërë nga Alban Pozhegu, Ushtrues Detyre i Departamentit të Prokurimit, i cili për një kohë është akuzuar se e ushtron këtë detyrë edhe pse nuk ka licencë për prokurim publik³, duke shkelur kështu pikën 2 dhe 3 të nenit 23 të Ligjit për Prokurim Publik⁴. Ndërkaq komisionit i hapjes është përbërë nga 5 persona nga departamenti i prokurimit të ministrisë.

Hapja e tenderit, sipas procesverbalit të hapjes së tenderit ka ndodhur më 24 Maj 2017, me ç’rast janë vlerësuar ofertat e pranuar si dhe operatorët ekonomikë për secilën pjesë/lot të kontratës. Gjithsej për këtë kontratë janë pranuar 5 tenderë. Në dokumentacionin që kemi marrë nga departamenti i prokurimit të ministrisë, nuk ka pasur oferta nga operatorët ekonomikë për lotet 2, 3 dhe 8. Ndërkaq sa i përket Lotit 9, nga dokumentet e shkëmbimit të email-ave mes Departamentit për Shërbime Farmaceutike-AFSH dhe Departamentit të Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë, është konstatuar se për shkak të nevojës së institucionit shëndetësor për produktin e Lotit 9, të inicohet kontraktimi me shkurtim afati.

Loti	Lloji i barnave	Forma farmaceutike	Vlera e parashikuar për lot
1	Sodium Valporate	Susp	29,900.00€
2	Metronidazole	Tbl	656,000.00€
3	Haloperidol	Tbl	980€
4	Salbutamol	Sol	75,000.00€

³ Zëri. (2017). *Ministri Rrahmani zgjedh shefin e prokurimit pa licencë prokurimit*. Qasur në: <http://zeri.info/aktuale/132698/ministri-rrahmani-zgjedh-shefin-e-prokurimit-pa-licence-prokurimi/>

⁴ Lëvizja FOL ka kontaktuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për të verifikuar nëse personi në fjalë, pra Ushtruesi i Detyrës së Shefit të Prokurimit është i pajisur me licencë që ia lejon nënshkrimin e kontratave që lidh Ministria e Shëndetësisë me operatorë ekonomikë. Sipas KRPP-së, ky zyrtar nuk posedon certifikatë prokurimi. Në fazën e tanishme FOL është duke hulumtuar rreth përgatitjes profesionale të zyrtarit në fjalë për të parë nëse posedon përgatitjen e nevojshme për të nënshkruar këto kontrata.

5	Salbutamol	Plv për inh	195,200.00€
6	Bacitracin+Neomzcin sulphate	Plv	79,800.00€
7	Procainebenzylpenicilin+Benzylpenicilin	Plv për sol për inj	142,000.00€
8	Ribavirin	Sol për inj	420,000.00€
9	Infliximab		170,000.00€

Table 1 Pjesët e kontratës me përmbajtje më të detajizuar

Operatorët ekonomikë që kanë dorëzuar oferta lidhur me këtë kontratë janë: “Dreni Pharm”, “Exclusive”, “ICN&BM”, “PHOENIX PHARMA” dhe “Pharmex”. Si të tillë këta operatorë ekonomikë kanë dhënë ofertuar për këto lote:

- Ndërmarrja Shëndetësore “Dreni Pharm” ka tenderuar për lotin 4;
- Sh.P.K. “Exclusive” ka paraqitur ofertë për lotin 7;
- N.T.P. “ICN & BM” ka paraqitur ofertë për dy lote, lotin 6 dhe 7;
- Sh.P.K. “Phoenix Pharma” ka dhënë ofertë për lotin 4 dhe 5;
- Sh.P.K. “Pharmex” ka paraqitur ofertë për lotin 1.

Operatori ekonomik	Loti	Çmimi I ofruar
"Pharmex"	1	29,640.00€
"Dreni Pharm"	4	88,887.50€
"Phoenix Pharma"	4	80,784.46€
"Phoenix Pharma"	5	294,648.04€
"ICN & BM"	6	69,920.00€
"Exclusive"	7	156,860.00€
"ICN & BM"	7	141,174.00€

Table 2 Çmimet e ofertave nga Operatorët ekonomikë për secilin lot




Table 3 Përshtatshmëria e ofertave të Operatorëve Ekonomikë kundrejt kritereve të Autoritetit Kontraktues

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit, Loti 5 është anuluar gjatë fazës së tenderimit me informatë sqaruese. Siq vërehet edhe nga grafiku, për këtë Lot, çmimi i ofruar nga Operatori

Ekonomik “Phoenix Pharma” ka qenë për 99,448.04 € më i lartë se çmimi i parashikuar nga Autoriteti Kontraktues. Kjo ka bërë që vetëm për Lotet 4 dhe 7 të ketë më shumë se një ofertë, ndërkaq në lotet tjera është shpallur fitues ofertuesi i vetëm.

Raporti i vlerësimit të tenderëve

Loti 1

Sipas raportit të vlerësimit të tenderëve, operatori ekonomik “Pharmex” Sh.P.K, ka qenë ofertuesi i vetëm për këtë lot. Sa i përket përshtatshmërisë administrative, ky tenderues ka plotësuar të gjitha kriteret dhe ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme administrative, për t’u konsideruar si i përgjegjshëm sa i përket kërkesave administrative.

Edhe në Kërkesat e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale, ky operatorë ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit të caktuar kohorë. Ndërkaq sa i përket Kërkesave ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale, kë tender figuron si i papërgjegjshëm pasi që në dokumentacion, i mungon Autorizimi për Marketing në Kosovë, me dozën e produkteve të kërkuara.

Edhe pse ky tender i plotëson kriteret rreth përshtatshmërisë administrative dhe profesionale, ky lot është anuluar për shkak të mospërputhjes së dozës së ofruar nga Operatori Ekonomik, kundrejt dozës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Loti 4

Në raportin e vlerësimit të tenderit, për Lotin 4 figurojnë dy oferta nga dy operatorë ekonomikë, N.Sh. “Dreni Pharm” dhe “Phoenix Pharma” Sh.P.K.

Lidhur me Përshtatshmërinë Administrative, të dy tenderët rezultojnë të përgjegjshëm duke plotësuar të gjitha kriteret e vëna nga Autoriteti Kontraktues dhe duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Edhe sa i përket Përshtatshmërisë së Pranueshmërisë dhe Përshtatshmërisë Profesionale, të dy tenderët janë vlerësuar si të përgjegjshëm. Ndërkaq tek kriteret rreth Kërkesave ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale, tenderi i “Phoenix Pharma” rezulton si i papërgjegjshëm në krahasim me atë të “Dreni Pharm”. Kjo pasi që, “Phoenix Pharma” i mungon Autorizimi për Marketing në Kosovë me dozën e produkteve të kërkuara dhe Licenca nga AKPM si qarkullues me shumicë i produkteve farmaceutike.

Duke marrë si kriter çmimin më të ulët, por edhe duke ndjekur përshtatshmërinë në kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktues, kontrata i ipet Operatorit Ekonomik “Dreni Pharm”.

Loti 5

Nga raporti i vlerësimit të tenderëve, për Lotin 5 ka pasur vetëm një ofertues, “Phoenix Pharma”. Ky operator ekonomik, rezulton si i përgjegjshëm sa i përket kërkesave administrative dhe kërkesave për përshtatshmërinë e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale.

Të gjitha dokumentet janë dorëzuar me kohë nga ky operator, ndërkaq janë plotësuar edhe kërkesat për gjendjen ekonomike, financiare, përshtatshmërinë e aftësive profesionale dhe teknike.

Edhe pse siq u pa më lartë, çmimi i ofruar nga ky operator ekonomik ka qenë dukshëm më i lartë se vlera e parashikuar, kjo ofertë prapë është konsideruar si e përgjegjshme, kurse loti në tërësi është anuluar për shkak se tenderi i vitit 2016 për të njëjtin artikull ka qenë i papërfunduar.

Loti 6

Siq edhe u cek më lartë, Loti 6, përkatësisht pjesa e kontratës me produktin Bacitracin +Neomzincsulphate është fituar nga Operatori Ekonomik "ICN & BM". Oferta e këtij operatori është vlerësuar si e përgjegjshme dhe janë respektuar të gjitha kriteret e vëna nga Autoriteti Kontraktues.

Megjithatë, me datë 09 Qershor 2017, ipet njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës, përkatësisht Lotit 6. Nga shkëmbimi i email-ave mes zyrtarëve të prokurimit, atyre të farmacistë dhe përfaqësueve të operatorit ekonomik, kemi arritur të kuptojmë se anulimi është bërë për shkak të hamendësimit nga departamenti i prokurimit se çmimi i ofruar nga operatori ekonomik është shumë më i lartë se çmimi i këtij produkti në treg.

Sipas monitorimit tonë ky arsyetim ka ardhur në mënyrë të papërgjegjshme, duke qenë se ka pasur mospërputhje mes çmimit të parashikuar (çmimi i parashikuar ka qenë 10,50 euro) dhe çmimit të tregut që e kanë deklaruar dy farmacistet që kanë qenë edhe në komisionin vlerësues (sipas tyre çmimi i tregut ka qenë 4 euro). Megjithatë në asnjë dokument nuk figurojnë deklaratat e dy anëtarëve të komisionit, duke bërë që tërë loti të anulohet vetëm për shkak të pohimeve verbale dhe jo zyrtare.

Përfaqësues të operatorit ekonomik, përkundër komunikimit të vazhdueshëm me departamentin e prokurimit, nuk kanë arritur të marrin përgjigje rreth shkaqeve të anulimit të pjesës së kontratës. Ata drejtojnë ankesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit duke cekur dispozitat ligjore të shkelura nga Autoriteti Kontraktues dhe duke arsyetuar çmimin dhe ofertën drejtuar këtij autoriteti.

Me datë 11 Korrik 2017, Ministria e Shëndetësisë pranon ekspertizën nga OSHP-ja lidhur me ankesën e Operatorit Ekonomik "ICN & BM". Sipas këtij dokumenti, zyra e prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik duke anuluar Lotin 6, pasi që çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik figuron të jetë për 15% më i ulët se çmimi i parashikuar. Për më tepër sipas mendimit të Ekspertit Shqyrtues ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar dhe duhet të anulohet vendimi për anulimin e kontratës.

Menjëherë pas pranimit të ekspertizës nga OSHP-ja, më 17 Korrik 2017, Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, merr vendim për të aprovuar si të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik, anulohet njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës, si dhe kthen në rivlerësim lëndën duke e obliguar Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave t'i përmbahet dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përkundër tërë zhvillimeve me OShP-në, me 10 Tetor 2017, AK Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratë me operatorin e njëjtë ekonomik dhe me të njëjtin çmim. Edhe pse veprimi i Ministrisë së Shëndetësisë duke anuluar këtë lot, bie në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, OShP nuk ka ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj këtij Autoriteti Kontraktues.

Loti 7

Për këtë pjesë të kontratës kanë qenë ofertues dy operatorë ekonomikë, “Exclusive” Sh.P.K dhe N.T.P “ICN & BM”.

Ofertat e të dy operatorëve ekonomikë “Exclusive” janë vlerësuar si të përgjegjshme sa i përket përshtatshmërisë së kritereve administrative, përshtatshmërisë profesionale dhe gjendjes ekonomike, financiare dhe teknike.

Megjithatë siq edhe e tregoi grafiku më lartë, këto dy oferta kishin dallime të dukshme në çmimin e ofruar. Çmimi i ofruar nga “Exclusive” ka qenë për 15,686 € më i lartë se çmimi i ofruar nga “ICN & BM”. Duke ndjekur çmimin më të lirë, si kriter për dhënie të kontratës, këtë lot e ka fituar operatori ekonomik “ICN & BM”.

Lot 1	Lot 4		Lot 5	Lot 6	Lot 7	
"Pharmex"	"Dreni Pharm"	"Phoenix Pharma"	"Phoenix Pharma"	"ICN & BM"	"Exclusive"	"ICN & BM"

Table 4 Fituesit për lotet e kontratës

Kontratrat publike

Në dokumentet që kemi marrë nga Departamenti i Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë, figurojnë 5 Kontrata Publike Kornizë. Nga këto kontrata, 3 prej tyre janë të lidhura me OE Exclusive, një me OE Dreni Pharm dhe një me OE ICN & BM.

Ndonëse nga analiza e mësipërme del që OE Exclusive nuk ka arritur të jetë i sukseshëm në lotin ku ka ofertuar, në dosjen e kontratës të monitoruar nga FOL, figurojnë edhe tri kontrata që ka lidhur ky operator me Ministrinë e Shëndetësisë për produkte tjera nga Lista Esenciale, e që nuk janë pjesë e kontratës që kemi monitoruar ne. Kjo vjen si rezultat i përzierjes së lëndëve të cilat figurojnë në dosjen e një kontrate të prokurimit. Qoftë kjo si pasojë e mbledhjes manuale të të dhënave dhe kopjeve fizike të dokumenteve, këtu paraqitet problemi i kategorizimit të lëndëve dhe ndarja e dokumenteve ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Nga këto kontrata rezulton se ky operator ekonomik, në kontratën me numër prokurimi 206-16-004-111, ka fituar lotet 27, 30, 39, 51, 62, 72 dhe 77, me vlerë totale prej 128,875 €. Ndërkaq në kontratën tjetër me numër prokurimi 206-16-003-111, ky operator është shpallur fitues në lotin 13 dhe 15, me vlerë totale 90,860 €.

Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratë publike me operatorin ekonomik “Dreni Pharm” për Lotin 4- Salbutamol Sol, për të cilin është vendosur afati kohor për dorëzim prej 30 ditësh.

Kurse me operatorin ekonomik “ICN & BM”, Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratë për Lotin 7-Procaïne benzylpenicilin+Benzylpenicilin, me të njëjtin afat kohor për dorëzimin e produktit të kontraktuar.

Që të dy këto pjesë të kontratës së monitoruar nga FOL, janë nënshkruar nga Ushtruesi i Detyrës së Udhëheqësit të Departamentit të Prokurimit, i cili dyshohet se nuk posedon certifikatë si zyrtarë përgjegjës i prokurimit, duke shkelur kështu Ligjin për Prokurimin Publik.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është analizuar kontrata me numër prokurimi 204-17-329-1-1-1, me titull “Furnizimi me etalon dhe pajisje laboratorike për nevojat e AMK-së⁵”. Si kategori, kjo kontratë hyn në kategorinë e furnizimeve me vendin e realizimit pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës. Kontrata ka qenë e ndarë në 7 lote, përkatësisht janë kërkuar 7 pajisje, vlera e parashikuar e të cilave rezulton 300,000 €.

Njoftimi për kontratë është përgatitur me 28 Shkurt 2017, ndërkaq njoftimi për dhënien e kontratës është përgatitur me datë 26 Maj 2017. Këto të dhëna figurojnë njëjtë edhe në faqen e KRPP-së. Të gjitha kontratat me operatorët ekonomikë, janë nënshkruar me datën 09 Qershor 2017.

Në përbërjen e komisionit për vlerësimin e ofertave të tenderit “Furnizim me etalon dhe pajisje laboratorike për nevojat e AMK-së”, kanë qenë tre antarë nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës. Edhe komisioni i hapjes së tenderit, ka pasur në përbërje tre anëtarë tjerë nga AMK-ja.

Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit, hapja e tenderit ka ndodhur më 11 Prill 2017, me ç’rast janë vlerësuar ofertat e pranuar si dhe operatorët ekonomikë për secilën pjesë/lot të kontratës. Gjithsej, për këtë kontratë janë pranuar 7 tenderë. Nga dokumentacioni që kemi marrë nga departamenti i prokurimit të ministrisë, kemi vërejtur që asnjë operatorë ekonomikë nuk ka dhënë ofertë për lotin 7 duke bërë që komisioni vlerësues të kërkojë anulimin e këtij loti. Ky lot tani është shpallur në retenderin me vlerë të parashikuar të kontratës prej 40,000 €.

Loti	Emërtimi i grupit	Vlera parashikuar e kontratës
1	Pajisjet për Laboratorin e masës	22,000
2	Pajisjet për laboratorin e vëllimit dhe rrjedhjes	7,000 €
3	Pajisjet për matjen e temperaturës dhe lagështisë relative	24,000 €
4	Pajisjet për laboratorin e forcës	80,000
5	Pajisjet për laboratorin e presionit	80,000
6	Pajisjet për laboratorin e metaleve të çmuara	40,000 €
7	Pajisjet për laboratorin e matjeve elektrike –Kohë dhe frekuencë	40,000

⁵ Agjencia e Metrologjisë së Kosovës

Table 5 Pjesët e kontratës dhe emërtimi i secilit lot

Rreth kësaj kontrate, gjithsej 7 operatorë ekonomikë kanë dhënë oferta për lote të caktuara. Operatorët ekonomikë, kanë ofertuar si në vijim:

- “KEIS” Sh.P.K., ka paraqitur ofertë për lotin 1, 4 dhe 6;
- N.T.P. “EUROLAB” ka paraqitur ofertë për lotin 1;
- “UNION” L.L.C. ka paraqitur ofertë për lotin 6;
- “NOVAMAT” ka paraqitur ofertë për lotin 3 dhe 4;
- “VITECH” Sh.P.K, ka paraqitur ofertë për lotin 5 dhe 6;
- N.P.P.IT “SIERRA” ka paraqitur ofertë për lotin 4;
- N.T.P. “ERAMED” ka paraqitur ofertë për lotin 1, 2, 3, 5 dhe 6

OE	Loti	Çmimi I ofruar
"KEIS"	1	89,520 €
"ERAMED"	1	129,800 €
"EUROLAB"	2	43,000 €
"ERAMED"	2	93,338 €
"NOVAMAT"	3	69,775 €
"ERAMED"	3	44,840 €
"KEIS"	4	73,882 €
"NOVAMAT"	4	77,130 €
"SIERRA"	4	87,002.68 €
"VITECH"	5	69,840 €
"ERAMED"	5	77,290 €
"ERAMED"	6	29,500 €
"VITECH"	6	54,070 €
"KEIS"	6	77,830 €
"UNION"	6	106,790 €

Table 6 Çmimet e operatorëve ekonomikë për lote




Table 7 Përshtatshmëria e operatorëve ekonomikë ndaj vlerës së dhënë nga Autoriteti Kontraktues

Nga dokumentacioni që kemi marrë nga Ministria e Shëndetsësisë, përgjatë shkëmbimit të email-ave mes zyrtarëve të prokurimit, kërkohet anulimi i lotit 1 dhe 2 për shkak se ofertat që

kanë ardhur nga operatorët ekonomikë për këto dy lote kanë tejkaluar limitet buxhetore të disponueshme nga Autoriteti Kontraktues. Siq edhe mund të shihet nga të dhënat, oferta që ka ardhur për lotin 1 është rreth katër herë më e lartë se vlera e parashikuar, kurse oferta për lotin 2 është rreth gjashtë herë më e lartë se vlera e parashikuar.

Raporti i vlerësimit të tenderit

Për dallim nga raporti i vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë, ku operatorët ekonomikë janë vlerësuar dhe krahasuar të ndarë nëpër lote, në raportin e vlerësimit të MTI-së, të gjithë operatorët ekonomikë janë vlerësuar sa i përket përshtatshmërive administrative, ekonomike, teknike dhe profesionale, kurse krahasimet dhe rekomandimet për fitues pastaj janë bërë duke inkluadruar edhe çmimet e ofruara për secilin lot.

Operatorët ekonomikë

1. N.T.P “EUROLAB”, sipas raportit të vlerësimit, sa i përket kërkesave formale dhe administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, është vlerësuar si i papërgjegjshëm, për shkak se në kërkesën *“Origjinali i tenderit dhe dy kopje”* i ka munguar një kopje duke bërë që menjëherë të diskualifikohet nga gara për marrjen e tenderit;
2. “UNION” L.L.C, sipas raportit të vlerësimit është konsideruar si i papërgjegjshëm për shkak se tek kriteret formale dhe administrative, në kërkesën *“Origjinali i tenderit dhe dy kopje”*, i ka munguar një kopje, duke bërë që të diskualifikohet menjëherë;
3. NPPIT “SIERRA”, rezulton si i papërgjegjshëm pasi që në kriteret për kërkesat formale dhe administrative, tek kërkesa *“Formulari i paraqitjes së tenderit i plotësuar dhe i nënshkruar si duhet”* ka dështuar të plotësojë formularin në bazë të teknikalitetëve të pëshkruara si dhe i ka munguar nënshkrimi;
4. “KIES” Sh.P.K, sipas raportit të vlerësimit por edhe në bazë të dokumenteve që kemi marrë nga dosja e tenderit, rezulton i përgjegjshëm sa i përket kriterëve formale dhe administrative të përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu edhe në kërkesat e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale të saktësuara në dosjen e tenderit, rezulton si operator i përgjegjshëm edhe pse i mungon *“Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Ekonomike”*. Njëjtë edhe tek kërkesat ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale, ky operator ka dorëzuar çdo dokument të nevojshëm;
5. N.T.N B&D Engineering & “NOVAMAT” Sh.P.K, sipas raportit të vlerësimit është diskualifikuar për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në pjesën e gjendjes ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale. Është konsideruar si i përgjegjshëm në kuadër të pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale edhe pse i ka munguar *“Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Ekonomike”*. Kurse arsyeja e diskualifikimit ka qenë mungesa e dokumenteve rreth kërkesës për aftësitë teknike dhe profesionale *“Së paku 1 kontratë për secilin Lot në natyrën e ngjashme e realizuar dhe e përcjellur me referenca për kontratat e njejta gjatë periudhës 2014-2016”*;
6. “VITECH” Sh.P.K, sipas raportit të vlerësimit, rezulton si i përgjegjshëm duke plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga dosja e tenderit, brenda afateve kohore dhe me të gjitha dokumentet e kërkuara;

7. N.T.P. "ERAMED", sipas raportit të vlerësimit, ky operator sa i përket përshtatshmërisë administrative dhe formale rezulton si i përgjegjshëm. Tek kërkesat e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale i mungojnë "Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrimin e dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Ekonomike" dhe "Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit", megjithatë prapë edhe për këtë kategori konsiderohet si i përgjegjshëm. Sa i përket gjendjes ekonomike, financiare dhe teknike e profesionale, operatori ka dorëzuar të gjitha dokumentet, përveq specifikave teknike që kanë qenë vetëm për lotin 6. Megjithatë edhe në këtë kategori, komisioni e ka vlerësuar si të përgjegjshëm.

Lot 3		Lot 4			Lot 5		Lot 6			
"Eramed"	"Novamat"	"Keis"	"Novamat"	"Sierra"	"Eramed"	"Vitech"	"Eramed"	"Vitech"	"Keis"	"Unic"

Table 8 Fituesit për lotet e kontratës

Kontratat publike kornizë

Pas vlerësimit të ofertave dhe operatorëve ekonomikë nga komisioni vlerësues, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lidhur 3 kontrata publike me tre operatorë të ndryshëm ekonomikë për pjesët e kontratës "Furnizim me etalon dhe pajisje laboratorike për nevojat e AMK-së".

Me operatorin ekonomik "VITECH" Sh.P.K, është lidhur kontrata për Lotin 5-Pajisjet për laboratorin e presionit dhe Lotin 6-Pajisjet për laboratorin e metaleve të çmuara. Afati kohor prej 90 ditësh është dhënë si kusht i dërgesës. Sipas planit të menaxhimit të kontratës, kontrata fillon nga data e dhënies së urdhërit të projekt menaxherit. Si aktivitet për implementimin e kontratës, nga dokumentet që kemi marrë nga shkëmbimi i email-ave rezulton se materiali i lotit 6 brenda afatit kohor ka filluar instalimin e kërkuar.

Me operatorin ekonomik N.T.P. "ERAMED", është lidhur kontrata për Lotin 3-Pajisjet për matjen e temperaturës dhe lagështisë relative, me të njejtin afat kohor prej 90 ditësh për realizimin e kontratës. Kurse me operatorin ekonomik "KEIS" Sh.P.K, është lidhur kontrata për Lotin 4-Pajisjet për laboratorin e forcës.

Konkluzione dhe rekomandime

Të dhënat e mësipërme janë tregues të mjaftueshëm për faktin se prokurimi publik mbetet një sektor që ende ka nevojë për transparencë ndaj taksapaguesve. Duke u nisur që nga Ministria e Infrastrukturës, e cila nuk ka ofruar qasje në asnjërën nga kontratat e kërkuara, e deri tek shkelja e ligjit të prokurimit publik nga zyrtarët në Ministrinë e Shëndetësisë, shihet qartë nevoja për monitorimin e vazhdueshëm të institucioneve sa i përket prokurimit publik.

Nevoja për të përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit në procesin e monitorimit të prokurimit publik tregon edhe njëherë se dispozitat ligjore nuk janë të mjaftueshme për të garantuar qasjen në dokumente publike. Lëvizja FOL ka ndjekur nga afër zhvillimin e hetimeve nga ky Institucion si dhe mbetet e përkushtuar që të bashkëpunojë me këtë institucion deri në marrjen e kontratës së kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Respektimi i Ligjit të Prokurimit Publik, mbetet një çështje shqetësuese, kundrejt të cilës institucionet përkatëse duhet të punojnë më shumë. Është e domosdoshme që zyrtarët në departamente të prokurimit të kenë kuaflifikimin e përcaktuar me ligj, në mënyrë që prokurimi të jetë legjitim dhe punët e kontraktuara të përfundohen me procedura të rregullta.

Për më tepër, përcëptimi për praninë e korrupsionit arsyetohet edhe me faktin se shumë zyrtarë të departamenteve të prokurimit kanë qenë të përfshirë në afëra korruptive dhe procese gjyqësore lidhur me parregullësi gjatë procesit të prokurimit dhe dhënie të tenderëve në mënyrë të kundërligjshme.

Në anën tjetër, mungesa e respektimit të ligjit vërehet edhe nga operatorët ekonomikë. Kriteret që vihen nga autoritetet kontraktuese derivojnë nga linjat ligjore, përmbushja e të cilave është e domosdoshme në mënyrë që aktivitetet e prokurimit të përfundohen me përgjegjësi. Prandaj, përmbushja e këtyre kriterëve nga operatorët ekonomikë ndikon jo vetëm në rritjen e konkurrencës por edhe do të rezultojë në një garë më kualitative ku diferencat e vogla do të bëjnë dallimin mes fituesve të aktivitetit të prokurimit.

Duke u nisur nga të gjeturat e mësipërme por edhe nga tërë procesi i monitorimit të këtyre kontratave, në mënyrë që prokurimi publik të jetë më transparent e të mos konsiderohet si burim i korrupsionit dhe keqpërdorimeve, Lëvizja FOL sjell këto rekomandime:

1. Për të evituar procesin e mbledhjes së dokumenteve të kontratave dhe marrjen e kopjeve fizike, platforma e-prokurimi, të jetë e qasshme edhe për përdoruesit që nuk janë operatorë ekonomikë;
2. Për të ngritur transparencën e tërë procesit të prokurimit dhe kontrollimin e shpenzimit të parasë publike, të lejohet qasja në platformën e-prokurimi edhe për qytetarët e jo vetëm për operatorët ekonomikë;
3. Për të promovuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, institucionet duhet të sigurohen që departamentet e prokurimit udhëhiqen nga zyrtarë të kualifikuar që posedojnë njohuritë dhe përvojën e mjaftueshme për të udhëhequr me aktivitetet e prokurimit;
4. Për t'i paraprirë një procedure të sukseshme të prokurimit, autoritetet kontraktuese duhet të planifikojnë saktë secilën pjesë të kontratës bashkë me buxhetin që kërkon, në mënyrë që të evitohet anulimi i kontratës për shkak të limiteve buxhetore;

5. Prokurimi publik duhet të jetë në monitorim të vazhdueshëm nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, për të evituar keqpërdorimet e mundshme dhe për t'u siguruar mbi mbarëvajtjen dhe implementimin e duhur të secilës kontratë;
6. Të merren parasysh ankesat e operatorëve ekonomikë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe të ndëshkohen autoritetet kontraktuese që në mënyrë diskriminuese favorizojnë operatorë të caktuar ekonomikë;
7. Hartimi i kriterëve dhe specifikave teknike të bëhet në mënyrë të atillë që nuk favorizon/diskriminon operatorë të caktuar ekonomikë;
8. Të evidentohen operatorët ekonomikë që ofertojnë me oferta shumë të larta dhe të papërgjegjshme;
9. Të lejohet pjesëmarrja e organizatave të Shoqërisë Civile në procesin e hapjes dhe vlerësimit të tenderëve për të siguruar transparencë në procesin e dhënies së kontratave.